



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosova
Qeveria - Vlada – Government

Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë
Ministarstvo Industrije, Preduzetništva i Trgovine
Ministry of Industry, Entrepreneurship and Trade

Agjencia për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë

**FTESË PUBLIKE
PËR PJESËMARRJE NË FORUMIN BIZNESOR
KOSOVË - JAPONI**

18 nëntor 2025

Vendi: Prishtinë

Adresa: Hotel Swiss Diamond

Me qëllim të promovimit të investimeve, eksporteve, si dhe zhvillimit të ndërmarrjeve kosovare, Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë (MINT), përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA), fton bizneset vendore të marrin pjesë në Forumin Biznesor Kosovë–Japoni, që do të mbahet më 18 nëntor 2025, në Prishtinë. Ky aktivitet organizohet nga MINT/KIESA, në bashkëpunim me Japan External Trade Organization (JETRO) dhe synon forcimin e bashkëpunimit ekonomik ndërmjet dy vendeve.

Një fokus i veçantë i forumit do t'i kushtohet takimeve B2B në sektorët si në vijim:

1. Sektori i përpunimit të metaleve
2. Sektori i teknologjisë së informacionit (IT)
3. Sektori i energjisë
4. Sektori i infrastrukturës.

Për të qenë pjesë e këtij aktiviteti, bizneset nga sektorët e lartpërmendur duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Certifikatën e regjistrimit të biznesit me të gjitha informacionet përcjellëse, në përputhje me sektorin përkatës;
2. Aplikacionin e plotësuar me të dhënat bazike të biznesit;
3. Kopjen e letërnjoftimit të personit të autorizuar të biznesit.

Dokumentet e lartpërmendura duhet të dërgohen në mënyrë elektronike deri më 13.11.2025, në orën 00:00, në e-mail adresën: invest.kiesa@rks-gov.net

Për informata shtesë mund të kontaktoni në numrin: +383 (38) 200 36 585.